



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

**V E N D I M**

**Nr. 44, Datë 07. 06. 2017**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa numër 107, datë 25.10.2016, e bërë nga B. B., kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore (në vijim ISSH) dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë (në vijim DRSSH), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të *“Gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të veçantë”*<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

B. B. deklaron se ka përfituar pagesë invaliditeti që prej vitit 2012 nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë. Sipas vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Korçë (KMCAP), nr. 1560, datë 10.06.2014, në muajin muajin Maj 2015, ankuesja duhej të paraqitej sërish për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të saj. Në këto kushte, ankuesja është paraqitur pranë DRSSH-së Korçë, në muajin Maj 2015 për të dalë përpara mjekëve të KMCAP-së për të vlerësuar aftësinë e saj për punë. Në këtë moment ka marrë takim me znj. Majlinda Jano, e cila e ka informuar se duhet të dalë përpara KMCAP-së Korçë në muajin Qershor 2015. E gjendur përpara këtij fakti, është paraqitur sërish në muajin Qershor pranë DRSSH-së Korçë dhe është informuar se dosja e saj është dërguar për në ISSH Tiranë, për tu vlerësuar nga ana mjekëve të KMCAP Epror, pasi nga ana e KMCAP-së Korçë është vendosur që është e aftë për punë të lehtë dhe nuk mund të përfitojë pagesë invaliditeti.

---

<sup>1</sup> Si nënë me shumë fëmijë

Sipas ankueses e gjithë procedura e sipërcituar është kryer pa dijeninë dhe praninë e saj nga ana e KMCAP Korçë. Megjithatë më datë 17.07.2015 është paraqitur pranë KMCAP Epror në Tiranë, i cili me vendim nr. 431, datë 17.07.2015, ka vendosur se ankuesja është e aftë për punë.

Duke mos rënë dakord me këtë, B. B., ka paraqitur verbalisht një ankesë, e cila mbahej në një rregjistër të posaçëm pranë KMCAP Epror. Që nga ai moment ankuesja nuk ka marrë asnjë përgjigje lidhur me ankimin e bërë. Në muajin Janar 2016, së bashku me dokumentacionin e rinovuar, i është drejtuar përsëri KMCAP-së Korçë për tu vlerësuar edhe një herë nga ky komision, mbi gjendjen shëndetësore të saj. KMCAP Korçë edhe në këtë rast përcaktoi se ankuesja është e aftë për punë dhe nuk është subjekt i përfitimit të pagesës së invaliditetit. Në këto kushte ka plotësuar një ankesë e cila është depozituar edhe në dosjen personale me Nr. 145502. Nga ana e KMCAP-së Korçë, pas ankesës së bërë nga ana e B. B., dosja është përcjellë për tu vlerësuar nga ana e KMCAP Epror. Në fund të muajit Shtator 2016, KMCAP Epror me vendim nr. 499, datë 30.09.2016, ka lënë në fuqi vendimin e marrë nga ana e KMCAP-së Korçë dhe ka përcaktuar se ankuesja është e aftë për punë. Në momentin që ankuesja ka dalë përpara KMCAP Epror, nuk është informuar mbi përfundimet e vlerësimeve të dhëna nga ana e mjekëve të këtij komisioni, por është vënë në dijeni se përgjigjen do ta marrë pranë DRSSH-së Korçë.

Në këto kushte, B. B. pretendon se, fakti që ajo është një nënë me shumë fëmijë, ka bërë që KMCAP Korçë, të marrë vendimin për mospërfitimin e pagesës së invaliditetit dhe ta trajtojë në mënyrë të diferencuar. Në dijeninë e saj, KMCAP Korçë trajton me pagesë invaliditeti edhe persona të tjerë me të njëjtën diagnozë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Mbështetur në nenin 33, pika 5 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me shkresën nr. 973/1 prot., është bërë njoftimi i DRSSH Korçë dhe KMCAP Epror lidhur me nisjen e procedurave të shqyrtimit të ankesës nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Me shkresën nr. 6994/1 prot., datë 22.11.2016, DRSSH Korçë informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesja, B. B., ku ndër të tjera sqaroi se: *Mbështetur në Rregulloren e datës 30.05.2005, miratuar midis ISSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve”, paragrafi i III, pika nr. 13, thuhet: Vendimi i KMCAP-it Epror të specializuar ka formë të prerë për invalidin ose të sëmurin. Ai nuk mund të ndryshohet nga KMCAP-i Rajonal*

*brenda afatit të shënuar në vendimin e KMCAP Epror të specializuar. Në ato raste kur KMCAP i DRSSH-së gjykon se invalidi paraqet gjendje shëndetësore të rënduar dhe bën objekt për të ndryshuar aftësinë për punë, ai merr vendim duke argumentuar arsyen e këtij ndryshimi. Por në këto raste, pavarësisht nga vendimi i KMCAP-it të DRSSH-së, Vendimi do të marrë formë të prerë vetëm mbas miratimit të KMCAP Epror të Specializuar. Për B. B. me numër dosje invaliditeti 145502/II KMCAP Epror ka vendosur me vendim nr. 431, datë 17.07.2015 se ankuesja është e aftë për punë dhe kjo përgjigje zyrtare e ardhur nga KMCAP Epror merret në DRSSH Korçë (kjo është praktika zyrtare, sepse dosja e invaliditetit të personit është dërguar zyrtarisht në ISSH, KMCAP Epror nga DRSSH Korçë). Aktualisht dosje e invaliditetit të zonjës me nr. 145502/II ndodhet në ISSH Tiranë, KMCAP Epror.”*

Më datë 06.01.2017, me anë të shkresës nr. 8835/3 prot., në përgjigje të kërkesave të shkresës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ISSH Tiranë, ndër të tjera sqaroi se: “Nga vlerësimi i dokumentacionit rezulton se, Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë Korçë, me vendim nr. 2162, datë 10.09.2012, ka vlerësuar B. B., invalide të plotë për periudhën 26.07.2012-30.06.2013, me diagnozë “Luxacion i Lartë Coxo Congenitale Bilaterale”, me datë fillimi invaliditeti 26.01.2012. Mbi bazën e këtij vendimi dhe në mbështetje të nenit 35, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, me vendim nr. 2169, datë 18.09.2012, i ndryshuar me vendim nr. 3195, datë 09.01.2013, i ka caktuar të interesuarës pension invaliditeti të plotë, me 21 vite e 4 muaj periudhë sigurimi (lloji i sigurimit, e vetëpunësuar në bujqësi), me të drejtë pagese nga data 26.07.2012, në masën 11,562 lekë/muaj. Ky përfitim është paguar deri më datë 30.06.2015. Dosja e përfitimit të B. B., është audituar nga mjekët e Sektorit të Ekspertizës mjekësore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Nga audituesit është lënë detyrë që dosja të rivlerësohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë Epror i Orthopedisë dhe ky i fundit me vendim nr. 431, datë 17.07.2015 e ka vlerësuar **“pa invaliditet, e aftë për punë të lehtë”** nga data 01.07.2015. Për këtë arsye dosja e përfitimit është mbyllur. Më datë 26.01.2016 B. B. është pajisur me Fletë-Drejtim të ri nga Komisioni Mjekësor i Kirurgjisë në Qendrën Shëndetësore Tiranë, me diagnozë “Luxacion coxofemoral congenital bilateral i lartë me coxoathrozë, Lordozë lumbare compesatore, Syndrom doloroze”. KMCAP Korçë me vendim nr. 1974, datë 26.07.2016 e ka vlerësuar “pa invaliditet, e aftë për punë të lehtë”. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KMCAP Epror i Orthopedisë me vendim nr. 499, datë 30.09.2016. Në mbështetje të nenit 39/1, pika 1, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, vendimi i KMCAP-it Epror të Orthopedisë është i formës së prerë. Në mbështetje të nenit 6 dhe 8, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, sigurimet shoqërore mbrojnë në mënyrë të detyrueshme të gjithë shtetasit ekonomikisht aktiv në Shqipëri, në rast të pakësimit të të ardhurave si pasojë e pleqërisë, invaliditetit etj. Kjo mbrojtje e detyrueshme vijon për aq kohë sa ekziston periudha e paaftësisë për punë. B. B. duke qënë e datëlindjes 15.04.1956, në mbështetje të nenit 31, pika 1 dhe nenit 92 të këtij ligji, ka lotësuar moshën për pension pleqërie më datë

*15.08.2016. me arritjen e moshës për pension pleqërie, B. B. nuk mund të kërkojë të trajtohet me pension invaliditeti, sepse periudha e moshës së aftësisë për punë, gjatë së cilës ka të drejtë të punësohet, por për shkak të gjendjes shëndetësore mund të ndodhë pakësimi i të ardhurave, ka mbaruar, për pasojë nuk është më në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme, por në kushtet e trajtimit me pension pleqërie."*

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve. Me shkresën nr. 973/3 prot., datë 27. 12. 2016, është bërë njoftimi i palëve për realizimin e seancës dëgjimore dhe është kërkuar të vihen në dispozicion:

Më datë 09.01.2017, sipas njoftimeve të realizuara, në seancë dëgjimore u paraqitën përfaqësues të Intitutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, I. M.dhe T. Gj., si dhe ankuesja, B. B. Nga DRSSH Korçë, nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Fillimisht mbështetur në kërkesat e parashtruara nga KMD, I. M. u shpreh se, duke qënë banore e qytetit të Korçës, B. B. është komisionuar nga specialisti orthoped, pranë KMCAP-së Korçë. Nga Sektori i Ekspertizës Mjekësore të ISSH-së, i cili merret me auditimin e të gjitha dosjeve të KMCAP-ve të Shqipërisë, është parë mangësi në dokumentacionin e dosjes së B. B. dhe është vlerësuar për t'u rikomisionuar. Në këto kushte, është komisionuar pranë KMCAP Korçë dhe KMCAP Epror dhe është vlerësuar që me diagnozën që B. B. ka, nuk është në kushtet që mund të përfitojë pagesë invaliditeti. Referuar legjislacionit në fuqi, ankuesja nuk mund të përfitojë pagesë invaliditeti.

Në vijim, B. B. shtoi se, në dijeninë e saj, në KMCAP Epror dhe në KMCAP Korçë, ka edhe persona të tjerë me të njëjtën diagnozë që përfitojnë pagesë invaliditeti

Në përfundim të seancës së realizuar, ISSH Tiranë vuri në dispozicion të KMD-së, dosjen e plotë të ankueses, në të cilën gjendet e gjithë procedura e ndjekur nga ana e KMCAP-së Korçë dhe atij Epror.

3. Mbështetur në Urdhërin nr. 9, datë 31.01.2017, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë zyrave të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë më datë 08.02.2017, për të administruar informacionin e kërkuar për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së B. B.

Gjatë inspektimit, përfaqësuesit e KMD-së, morën takim me F. Zh., me detyrë Kryetar i Degës së Administrimit të DRSSH-së Korçë dhe Gj. Sh., me detyrë Specialist i Ekspertizës Mjekësore të KMCAP-së Korçë.

Gj. Sh. sqaroi se, mbështetur në Kriteret e Caktimit të Aftësisë për Punë, individët me diagnozën e B. B., aktualisht nuk mund të përfitojnë pagesë invaliditeti. Gjithashtu, për diagnozën e B. B., si dhe personat që kanë lindur me këtë sëmundje, nuk mund të përfitojnë pagesë invaliditeti.

Në vijim, nga ana e përfaqësuesve të DRSSH-së Korçë, u deklarua se, pas një kontrolli të ushtruar nga ana e Sektorit të Ekspertizës Mjekësore të ISSH-së Tiranë (Auditi), është vlerësuar dhe është lënë detyrë që dosja e B. B. dhe disa dosje të tjera të dërgoheshin për rikontroll pranë KMCAP Epror (fakt ky i dokumentuar edhe në Projekt-Raportin e Invaliditetit të DRSSH-së Korçë, ku rekomandohet nga Sektori i Ekspertizës Mjekësore për rikontroll në KMCAP Epror).

Gjatë inspektimit, përfaqësuesit e KMD-së kontrolluan Rregjistrin e KMCAP të Rrethit Korçë, për periudhën Janar 2015-Dhjetor 2016, në të cilin evidentoheshin të gjithë personat e komisionuar pranë këtij institucioni për këtë hark kohor. Nga inspektorët u seleksionuan dhe u administruan si prova materiale, rastet e komisionuara me të njëjtën diagnozë (Luxacion koskofemoral kongenital bilateral i lartë) të ankueses, B. B.

4. Mbështetur në Urdhërin nr. 18, datë 16.02.2017, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë zyrave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë më datë 08.02.2017, për të administruar informacionin e kërkuar për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së B. B.

Gjatë inspektimit, përfaqësuesit e KMD-së, morën takim me I. M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ekspertizës Mjekësore, T. Gj., me detyrë Specialiste e Sektorit të Ekspertizës Mjekësore dhe L. M., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Përfitimeve të ISSH-së Tiranë.

Në vijim të inspektimit, përfaqësuesit e ISSH-së Tiranë ndër të tjera informuan se, çdo rast i cili komisionohet pranë KMCAP Epror shihet bazuar në dokumentacionin e dosjes përkatëse dhe disa kritere të tjera që vlerësohen rast pas rasti, mbështetur në legjislacion. Përsa i përket diagnozës së B. B., ligjërisht ajo nuk mund të përfitojë pagesë invaliditeti.

Gjatë inspektimit, përfaqësuesit e KMD-së kontrolluan Rregjistrin e KMCAP Epror për Orthopedinë, për periudhën Korrik 2016- Shkurt 2017, lidhur me rastet e komisionuara me të njëjtën diagnozë (Luxacion koskofemoral kongenital bilateral i lartë) të ankueses, B. B.

Në përfundim I. M. shtoi se, çdo rast i trajtuar nga KMCAP Epror, ka specifika të veçanta, si p.sh.: moshë, profesioni, gjendja e përgjithshme shendetësore, të cilat shihen rast pas rasti nga anëtarët e KMCAP Epror. KMCAP Epror është vendimmarrës në këtë proces.

**Për sa më sipër, gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.**

**Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:**

**Lidhur me trajtimin ndryshe dhe të pafavorshëm për shkakun e pretenduar nga ankuesja.**

Shteti shqiptar ka miratuar një korpus të tërë aktesh ligjore dhe nënligjore, nëpërmjet të cilave rregullon ligjërisht ndihmën dhe shërbimet shoqërore. Pagesa e invaliditetit është një ndër përfitimet që personat me aftësi të kufizuar mund të marrin nga shteti, si bonus, në ndihmë dhe në shërbim të tyre. Në bazë të dispozitave përkatëse, këtë pagesë nuk mund ta përfitojnë të gjithë personat me aftësi të kufizuar, por vetëm invalidët të cilët janë deklaruar të tillë me vendim të KMCAP-së. Më poshtë bëjmë një analizë të legjislacionit përkatës.

Në nenin 35, të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohen shprehimisht kushtet e përfitimit të pensionit të invaliditetit. Dispozita e sipërpërmendur parashikon se:

***1. Personi që bëhet i paaftë merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye, veç aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Ai e merr këtë pension kur bëhet i paaftë:***

*a) për çdo veprimtari ekonomike;*

*b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin). Invaliditeti caktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij, si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve Eprorë caktohen me këtë Ligj. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve të nivelit të parë caktohen me Rregulloren të ISSH-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë.*

*2. Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror. Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti;*

**3. Personi që përfiton pension për invaliditet, kur plotëson moshën, ka të drejtë të kërkojë pension pleqërie, nëse ky do të jetë më i favorshëm për të.**

*Invaliditeti caktohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP). Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë. **Kundër vendimit të KMCAP-it të rrethit personi mund të ankohet në KMCAP-in Epror pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, vendimi i të cilit përsa i përket caktimit të aftësisë për punë është i formës së prerë. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve caktohen me rregullore të ISSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.***

Në nenin 7 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2015 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, përcaktohen shprehimisht kategoritë e personave që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar. Dispozita e sipërpërmendur parashikon se:

*“Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:*

- 1. ....*
- 2. ....*
- 3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).*
- 4. Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, sipas Statusit të invalidit të punës”.*

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 07.09.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar, në pikën I të tij përcakton kriteret dhe grupet që përfitojnë pagesën për aftësi të kufizuar.

- 1. Personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikiko/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar. Personat, paraplegjikë e tetraplegjikë, të cilët deklarohen, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkak dhe mosha, përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.*

2. *Personat me aftësi të kufizuar, të përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, të cilët, me vendim të komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një kujdestar me pagesë.*
3. *Vlerësimi i gjendjes mjekësore të personave me aftësi të kufizuar, të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, bëhet nga KMCAP-i, i cili është i ngritur dhe funksionon pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ku merr pjesë, si anëtar me të drejtë vote, edhe mjeku, punonjës i Shërbimit Social Shtetëror.*
4. *Shpenzimet për pagesën e anëtarëve të KMCAP-it përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përveç pagesës së mjekut, i cili është punonjës i Shërbimit Social Shtetëror.*
5. *Invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Shërbimit Social Shtetëror.*
6. *Kriteret mjekësore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta”.*

Sikurse vihet re nga parashikimi i pikës I/ 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 07.09.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar, janë KMCAP-të ato, të cilat bëjnë vlerësimin e gjendjes shëndetësore të personit me aftësi të kufizuar, nëse ai mund të përfitojë pagesë paaftësie.

Referuar parashikimeve të nenit 39/1, të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohen shprehimisht kushtet e përfitimit të pensionit të invaliditetit dhe rezulton se vendimet e KMCAP Rajonale<sup>2</sup> mund të apelojnë pranë KMCAP Epror, dhe vendimi i këtij të fundit ka formë të prerë për invalidin ose të sëmurin.

Mbështetur në pikën I/6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 07.09.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar, i referohemi një akti tjetër tepër të rëndësishëm nënligjor,

<sup>2</sup> Shih pikat 10 dhe 13 të Rregullores së datës 30.05.2005 “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë të Individueve”.

pikërisht Urdhërit nr. 276, datë 08.02.2007 të Ministrit të Punëve dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrit të Shëndetësisë “Për miratimin e rregullores për kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar”. Ky akt nënligjor merr përsipër të rregullojë në mënyrë të hollësishme, kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Gjithashtu, kriteret mjekësore për vlerësimin e aftësisë për punë, përcaktohen më hollësisht në Rregulloren datë 24.11.2010 “Për miratimin e kriterëve të rishikuara”, në të cilën Ministri i Shëndetësisë ka miratuar “*Kriteret e rishikuara të caktimit të aftësisë për punë*”.

Në pikën X të Rregullores së sipërcituar, ku përcaktohen diagnozat përkatëse për: “Sëmundjet Ortopedike dhe Traumat Lokomotore”, vihet re se:

*1. Luksacionet kongenitale kokso-femorale:*

- a. Janë në kushtet e përfitimit si persona me aftësi të kufizuar të përkohshme për 1 vit, gjatë trajtimit konservativ me imobilizim në gips, jastek pneumatik abduktor apo shina abduktore.*
- b. Janë në kushtet e përfitimit si persona me aftësi të kufizuar të përkohshme për 1 vit gjatë trajtimit kirurgjikal.*
- c. janë në kushtet e përfitimit si persona me aftësi të kufizuar të përkohshme për 1 vit, të gjitha rastet me ndërlikime gjatë trajtimit konservativ apo kirurgjikal të luksacionit kongenital kokso-femoral sikundër është nekroza e kokës femurit, anteversioni i skajit të sipërm femoral, etj. Ky përfitim nis nga momenti i fillimit të trajtimit të ndërlikimit.*

Përsa parashikohet edhe në Rregulloren për kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, ku përcaktohen diagnozat përkatëse për: “Sëmundjet Ortopedike dhe Traumat Lokomotore”, vihet re se diagnoza “*L.C.F. bilateral kongenital i lartë*”, nuk është pjesë e kriterëve mjekësorë të përfitimit të pensionit të invaliditetit të përheshëm, por vetëm për një periudhë 1 vjeçare.

Mbështetur në provat e administruara, B. B., me vendim nr. 2162, datë 10.09.2012, të KMCAP-së Korçë, ka përfituar pagesë invaliditeti të plotë për periudhën 26.07.2012-30.06.2013, me diagnozë “*Luxacion i Lartë Coxo Congenitale Bilaterale*”. Mbi bazën e këtij vendimi dhe në mbështetje të nenit 35, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, me vendim nr. 2169, datë 18.09.2012, i ndryshuar me vendim nr. 3195, datë 09.01.2013, i ka caktuar pension invaliditeti të plotë, me 21 vite e 4 muaj periudhë sigurimi (lloji i sigurimit, e vetëpunësuar në bujqësi). Ky përfitim është paguar deri më datë 30.06.2015.

Pas kontrollit të 2050 dosjeve të invaliditetit të audituara nga mjekët e Sektorit të Ekspertizës Mjekësore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, është lënë detyrë që dosja e ankueses dhe 30 dosje të tjera rivlerësohen nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë Epror në ISSH Tiranë.

Në vijim të procedurave, të zhvilluara nga ana e KMCAP Epror Tiranë, është vendosur që B. B. të konsiderohet *“pa invaliditet, e aftë për punë të lehtë”* nga data 01.07.2015. Për këtë arsye dosja e përfitimit është mbyllur.

KMCAP Korçë me vendim nr. 1974, datë 26.07.2016 e ka vlerësuar sërish ankuesen dhe ka cilësuar si *“pa invaliditet, e aftë për punë të lehtë”*. Vendim i cili është lënë në fuqi edhe KMCAP Epror i Orthopedisë më datë 30.09.2016.

**Mbështetur në provat dhe faktet e administruara nga kontrolli i Rregjistrit të KMCAP-së së Rrethit Korçë, për periudhën Janar 2015-Dhjetor 2016 dhe Rregjistrin të KMCAP Epror për periudhën Korrik 2016- Shkurt 2017, rezultoi që, nuk kishte asnjë përfitues të pensionit të invaliditetit me diagnozën e B. B. E njëjta situatë u konstatua edhe nga kontrolli i Rregjistrit të KMCAP Epror për Orthopedinë. Ky fakt, bie në kundërshtim me pretendimet e ankueses, se në KMCAP Korçë dhe në KMCAP Epror Tiranë, ka persona të tjerë të komisionuar, të cilët përfitojnë pension invaliditeti, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.**

**Në referim të legjislacionit të sipërcituar, ankuesja me diagnozën që ka, nuk mund të përfitojë pension invaliditeti nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, pasi dispozitat ligjore parashikojnë një periudhë përfitimi të pensionit të invaliditetit për këtë diagnozë jo më shumë se 1 vit, për rastet pas trajtimit kirurgjikal.**

Në përfundim të trajtimit të ankesës, u konstatua se B. B. duke qënë e datëlindjes 15.04.1956, në mbështetje të nenit 31, pika 1 dhe nenit 92 të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, ka plotësuar moshën për pension pleqërie më datë 15.08.2016.

Përsa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka bindjen se veprimet e ndërmarra nga ana e KMCAP Korçë dhe KMCAP Epror, nuk janë bërë në mënyrë të qëllimshme dhe tendencioze me synimin për të përjashtuar ankuesen nga e drejta për të përfituar pension invaliditeti.

Në këtë kontekst, referuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se B. B.,

nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e KMCAP Korçë dhe KMCAP Epror.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të B. B., nga ana e KMCAP Korçë dhe KMCAP Epror, për shkak *gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të veçantë<sup>3</sup>*.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

(Shkaku: Gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar dhe përkatësia në një grup të veçantë)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)

---

<sup>3</sup> Si nënë me shumë fëmijë